



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2018:030015

Datë: 29.08.2024

Numri i dokumentit: 06099845

**2018:030016**

**( PKR.nr. 113/18)**

### **NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, DIVIZIONI PENAL**, gjyqtari i vetëm gjykues Imri Sejda, me zyrtaren ligjore Kimete Bytyqi, në çështjen penale kundër të pandehurit V.G., për shkak të veprave penale Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së dhe Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së, duke vepruar sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Ferizaj-Departamenti i përgjithshëm PP/L.nr.85/2018, e dt.21.06.2018, ka mbajtur shqyrtimin fillestar publik më datë 23.08.2024, në prani të Prokurorit së Shtetit Sadat Topalli, të pandehurit dhe mbrojtësit të tij të caktuar sipas detyrës zyrtare av. Burim Krasniqi dhe me dt.26.08.2024 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa më datë 29.08.2024, përpiloi këtë:

### **A K T G J Y K I M**

I pandehuri V.G., nga i ati I., e ëma M., e gjinisë M., i lindur me dt.... në Ferizaj ku dhe tani jeton rruga “ ...” ndërtesa kati i ... nr, ... (ndërtesa tek s. DR. M.), me numër personal ..., ka të kryer shkollën fillore, i pa martuar, punëtor në ndërtimtari, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i pa dënuar më parë për ndonjë veprë penale, ndaj tij nuk zhvillohet ndonjë procedurë tjetër penale, numri i telefonit (04.-... ..).

### **Ë S H T Ë F A J T O R**

## I

Se me datë 16.05.2018 rreth orës 10:50, në rrugën “...” në Ferizaj, me qëllim të frikësimit të dëmtuarit –K.I., pas një fjalosje që kishte pasur me këtë të fundit, i pandehuri në mënyrë kërcënuese ka përdorur armën e llojit “Ecol Special”, numër serik EV-1..., në atë mënyrë që fillimisht e ka nxjerrë pistoletën nga brezi e më pas e ka raportitur në drejtim të tij, në atë moment i dëmtuari i frikësuar ik nga vendi i ngjarjes, më pas nga hetimi i policisë i pandehuri arrestohet dhe arma i konfiskohet.

Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

## II

Se me datë 16.05.2018 rreth orës 10:50, në Ferizaj, në shtëpinë e tij pas një kontrole të kryer nga ana e policisë, i pandehuri duke vepruar në kundërshtim me nenin 18 dhe nenin 4 të Ligjit mbi Armët, ka pasur në posedim –armën e tipit “Escol Special”, me numër serik EV-..., pa leje dhe autorizim , e cila armë i është konfiskuar nga ana e policisë.

Me këtë ka kryer veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 paragrafi 1 Kodit Penal të Republikës së Kosovës .

Andaj gjykata në bazë të neneve 4, 7, 17, 21, 41, 42, 43, 46, 47, 73, 74 dhe neneve 375 e 374 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), dhe neneve 364 dhe 452 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (KPPRK), të pandehurin e:

## GJYKON

Për pikën 1. të dispozitivit, me dënim me gjobë, në shumë prej 500 € /pesëqind / dhe me dënim me burg në kohëzgjatje prej 6 / gjashtë / muajve, i cili dënim me burg konform nenit 46 të KPRK-së, me pëlqimin e të pandehurit i zëvendësohet me dënim në gjobë në shumën prej 600 € / gjashtëqind euro/.

Dhe:

Për pikën 2. të dispozitivit me dënim me gjobë, në shumë prej 500 /pesëqind / Euro,

Gjykata konform nenit 80 të KPRK-së, të pandehurin e,

### **GJYKON ME DËNIM UNIK**

Me dënim me gjobë, në shumë prej 1600 /njëmijë e gjashtëqind / Euro, të cilën gjobë është i obliguar ta paguaj në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në rast se i pandehuri nuk e paguan dënimin me gjobë në asnjë mënyrë, sipas nenit 476par. 3 të KPK-së, i njëjti dënim do t'i shëndrrohet në dënim me burgim ashtu që për çdo 20 Euro, do t'i llogaritet një (1) ditë burgim.

Obligohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 30 Euro (tridhjetë euro), si dhe konform nenit 36 par. 3 pika 3.1 të ligjit Nr. 08/L-109, për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej nga 20 /njëzet/ Euro, që të dyja shumat brenda afatit prej 30 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

Konform nenit 374 par. 3 dhe nenin 69 të KPPRK-se, i konfiskohet në mënyrë të përhershme një (1) armë e llojit "Ecol Special", numër serik EV-....

### **A r s y e t i m i**

Prokuroria Themelore Ferizaj-Departamenti i përgjithshëm ka paraqitur aktakuzën PP/L.nr.85/2018, e dt.21.06.2018, ka ngarkuar të pandehurit për shkak të veprave penale, Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së dhe Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së, dhe ka kërkuar që i pandehuri të shpallet fajtor dhe t'i shqiptohet sanksioni penal i paraparë me ligj.

Gjykata pasi studioi materialet e çështjes penale te paraqitur për gjykim, çmoi se çështja është në juridiksionin e saj dhe gjykimi i kësaj çështje penale duhet të realizohet përpara kësaj gjykate. Po kështu është në kompetencën lëndore dhe territoriale të kësaj gjykate, pasi veprat penale për te cilën është proceduar i pandehuri gjykohet nga gjyqtari i vetëm gjykues dhe vendi ku janë kryer ose tentohet të kryhen veprat penale.

Gjykata duke vepruar sipas akuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj, caktoi dhe mbajti shqyrtimin fillestar me datë 23.08.2024, në të cilën seancë kanë prezantuar prokurori i shtetit, i pandehuri dhe mbrojtësi i tij i caktuar sipas detyrës zyrtare.

Në fillim të shqyrtimit gjyqësor, gjyqtari i vetëm gjykues ka udhëzuar të pandehurin për të drejtat e tija në kuptim të nenin 241 par.1 të KPPRK-së, dhe pasi që i pandehuri ka deklaruar se i ka kuptuar në tërësi udhëzimet e dhëna nga gjykata, shqyrtimi fillestar ka vazhduar me leximin e aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit dhe pasi që gjyqtari është bindur se i pandehuri e ka kuptuar në tërësi aktakuzën, në pajtim me neni 241 paragrafi 4 të KPPRK-së, i ka afuar mundësinë që të deklarohet lidhur me fajësinë apo pa fajësinë për veprën penale për të cilën është i akuzuar.

I pandehuri në shqyrtimin fillestar publik ka deklaruar, se e pranoj fajësinë për veprat penale që më ngarkon aktakuza sipas të gjitha pikave të saja, për veprat penale Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së dhe Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së, jam i njoftuar me pasojat e pranimi të fajësisë, pranimin e fajit e bëj në mënyrë vullnetare dhe atë pas konsultimeve të mjaftueshme me avokatin tim mbrojtës, ndihem thellë i penduar, jam i vetëdijshëm për pranimin e fajësisë dhe pasojat që mund të më vijnë, është hera e parë që kam ra ndesh me ligjin dhe premtoj se në të ardhmen nuk do të përsërisë vepër tjetër penale.

Prokurori i shtetit lidhur me pranimin e fajësisë së të pandehurit deklaroi se pajtohem me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit për veprat penale Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së dhe Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së, pasi që pranimi është bërë në mënyrë vullnetare duke kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë. Ky pranim është në pajtim me dispozitat e nenin 242 të KPPRK-së, në mbështetje të provave dhe fakteve që i përmban aktakuza, andaj i propozoj gjykatës që të njëjtin ta shpall fajtor dhe ti shqiptoj një

sanksion penal të paraparë me ligj. Lidhur me shqiptimin dhe lartësinë e sanksionit penal i propozoj gjykatës që të ketë për bazë rrethanat rënduese dhe lehtësuese të parapara në nenin 69 dhe 70 të KPRK-së, i propozoj gjykatës që të pandehurit ti shqiptoj dënim të paraparë me ligj. Gjithashtu i propozoj gjykatës që konfrom dispozitave ligjore të nenit 374 par. 3 dhe nenin 69 par. 1 i KPPRK-së të konfiskohet arma e cekur në dispozitivin e aktakuzës.

Mbrojtësi i të pandehurit lidhur me pranimin e fajësisë së të pandehurit deklaroi se pasi që pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare nga i mbrojturi im i njëjti pranim është bërë pas konsultimeve të mjaftueshme me mua si mbrojtës rreth beneficionet dhe pasojave që i ka pranimi i fajësisë, andaj i propozojmë gjykatës që të marr vendim meritore lidhur me pranimin e fajësisë. Sa i përket shqiptimit dhe matjes së dënimit kërkojmë nga gjykata që pranimin e fajësisë ta vlerësoj si rrethanë veçanërisht lehtësuese po ashtu edhe si rrethana tjera lehtësuese ta vlerësoj edhe moshën e re të mbrojturit tim i cili ato ditë vetëm sa i kishte mbushur 18 vite, si rrethanë lehtësuese të merret edhe se i njëjti ka qenë i provokuar nga i dëmtuari K. dhe shokët e tij, po ashtu se i njëjti është përdorur për veprimet të cilat i ka bërë ka premtuar se në të ardhmen nuk do të përsëris vepra të tilla, andaj i propozoj gjykatës që gjatë matjes së dënimit konform nenit 71 dhe 72 të bëj zbutjen e dënimit dhe dënimin e paraparë me burgim për veprën e parë penale të ia zëvendësoj me dënim me gjobë duke marrë parasysh se vepra penale ka ndodh para disa vite dhe nga ajo kohë e gjer më tani i njëjti nuk ka përsëritur ndonjë veprë tjetër penale.

Gjykata për të vlerësuar pranimin e fajësisë shqyrtoi me kujdes kushtet e parapara nga neni 242 par. 2 të KPPK-së dhe me këtë rast vlerësoi se i pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, pranimi i fajit është bërë vullnetarisht nga i pandehuri dhe atë pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij, pranimi i fajit nuk është rezultat i përdorimit të forcës, kërcënimeve apo premtimeve, se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike, pranimi i fajit mbështetet në fakte dhe prova materiale të rastit konkret dhe atë me provat e paraqitura nga Prokurori i Shtetit siç janë: deklarata e të pandehurit e dhënë në polici me dt.16.05.2018, deklarata e të dëmtuarit me dt.16.04.2018, vërtetimi mbi bastisjen e shtëpisë me dt. 16.05.2018, vërtetimi për konfiskimin e sendeve i dt.16.05.2018, fotografit dhe shkresat tjera të lëndës.

Meqenëse i pandehuri e ka pranuar fajësinë e cila është në përputhje me kriteret e përshkruara më lartë, gjykata në bazë të nenit 242 paragrafi 6 të KPPK-së, ka vlerësuar se nuk është e nevojshme vërtetimi i ndonjë fakti relevant për shqiptimin e dënimit dhe për këtë arsye ka vazhduar me shqiptimin e dënimit. *( nëse i pandehuri në shqyrtim fillestar pranon fajësinë dhe kryetari i trupit gjykues vlerëson se pranimi i fajit është bërë në pajtim me ligjin mund të vazhdoj procesin me shqiptimin e dënimit pa plotësuar trupin gjykues dhe pa e mbajtur fare shqyrtimin gjyqësor, lidhur me këtë shih mendimin juridik të gjykatës supreme të evidentuar si GJA nr.207/13 të dt.19.03.2013).*

Duke vlerësuar në aspektin juridik, gjykata gjeti se në veprimin e të pandehurit ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprave penale, Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së dhe Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së, ashtu siç është theksuar në dispozitiv të këtij aktgjykimi, në të cilin është përshkruar data, vendi, koha dhe mënyra apo rrethanat e kryerjes së veprave penale, për çka dhe i pandehuri u shpallë fajtor dhe ju shqiptua dënim siç është theksuar në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me rastin e matjes dhe caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit për të pandehurin, gjykata vlerësoj rrethanat në kuptim të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së, dhe gjeti si rrethanë veçanërisht lehtësuese se i pandehuri e ka bërë pranimin e fajësisë, duke e shprehur pendimin e singertë dhe të thellë dhe keqardhjen për veprat penale të kryera, premtimin e tij se në të ardhmen nuk do të përsërit vepër të tillë apo të ngjashme, se më parë nuk ka qenë i dënuar me ndonjë aktgjykim të formës së prerë për ndonjë vepër penale, moshën e re që ka pasur në rastin e kryerjes së veprave penale, ndërsa rastin konkret nuk gjeti ndonjë rrethanë rënduese përveç që vlerësoj shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit si dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale.

Gjykata është e bindur se edhe me dënime të tilla, duke marrë parasysh edhe faktin se i pandehuri ka bërë pranimin e fajësisë do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë në nenin 41 të KPRK-së, përkatësisht dënimet e shqiptuara janë plotësisht të justifikueshme, në përshtatje me rrethanat e kryerjes së veprave penale, rrezikshmërisë së tyre dhe autorit të saj, që do të shërbej në parandalimin e kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen ( preventiva speciale) si dhe do të arrihet qëllimi të përmbaj personat tjerë nga kryerja e veprave penale (preventiva gjenerale).

Vendimi për konfiskim, është marrë në kuptim të dispozitës së nenit 366 par.3 të KPPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet paushallë, është marrë në kuptim të dispozitës së nenit 452 par. 1 të KPPRK-së.

Vendimi për kompensimin e viktimave të krimit është marrë konform nenit 36 par 3 pika 3.1, Nr. 08/L-109 të ligjit për kompensimin e Viktimave të Krimit.

Në bazë të theksuarave më lartë u vendos si në dispozitivit të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE FERIZAJ,  
DEPARTAMENTI PËRGJITHSHËM, DIVIZIONI PENAL  
2018:030016, (PKR nr. 113/18) datë 29.08.2024**

**Zyrtare ligjore  
Kimete Bytyqi**

**Gjyqtari i vetëm gjykues:  
Imri Sejda**

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej tridhjetë (30) ditësh, llogaritur nga dita e pranimit të tij. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe Gjykatën.